



KOHA DITORE



e hënë • 10 gusht 2015

Numri 6507 • Çmimi 0.50 €

www.koha.net

ANALISTË NËRDKOMBËTARË THONË SE GJYKATA SPECIALE NUK DO TË MUND T'I TRAJTOJË TË GJITHA KRIMET

Krimet jashtë raportit të Martyt, t'i gjykojë Kosova

James Ker-Lindsay, nga Instituti i Londrës për Shkenca Politike dhe Ekonomi (LSE), ka thënë se Kosova, pavarësisht themelimit të Gjykatës Speciale, duhet të dëshmojë përkushtim që t'i trajtojë krimet e tjera të cilat nuk janë të përfshira në raportin e Dick Martyt. Por avokatit ndërkombëtar, Alexander Borg Olivier, e ka quajtur fatkeqësi për Kosovën themelimin e Speciales dhe se nuk pret ndonjë sukses nga kjo gjykatë

Fitim Gashi

PRASITËSE, 9 GUSHT – Kosova duhet të dëshmojë se është e aftë t'i gjykojë edhe vete krimet e luftës, të cilat nuk do të mund t'i trajtojë Gjykatat Speciale për shkak të kufizimit të periudhës kohore, kanë thënë analistë ndërkombëtarë. Gjykatat Speciale do të ketë jurisdikcion mbi krimet që pretendohet se i kanë kryer drejtues të UÇK-së gjatë viteve 1998-2000, të cilat gjenden në Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës, autor i të cilit është senatori Dick Marty.

James Ker-Lindsay, hulumtues i lartë në Shkollën për Shkenca Politike dhe Ekonomi (LSE), ka thënë se Kosova duhet ta ndjekë shembullin e fqinjëve, duke trajtuar krimet brenda sistemit të vet gjyqësor.

"Siç e kemi parë në të gjithë ish-Jugosllavinë, ndërsa figura të larta të akuzuara për kryerjen e shumë të këqijave e krimeve të luftës, janë gjykuar në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës - ka pasur edhe gjyqe për krimet e luftës brenda Serbisë, Bosnjes dhe Kroacisë", ka thënë Lindsay. "Çdokush pret që kjo përfundimisht do të ndodhë edhe në Kosovë". Edhe pse EULEX-i është i angazhuar në disa hetime, sipas Lindsay, shumë pak gjykime janë bërë deri tani.

"Në këtë fazë, unë mendoj se vëmendja është vënë në gjykatën e specializuar, sepse hapat e parë duhet të ndërmerren për të treguar


se krimet e luftës mund të kenë ndodhur dhe se njerëzit të gjykojnë për këtë. Pas kësaj, unë mendoj se do të behen përpjekje për tu marrë me rastet e tjera në Kosovë dhe brenda sistemit standard gjyqësor të Kosovës", ka theksuar Lindsay.

Njohësi i çështjeve të Ballkanit, ka shtuar se pasojat për Kosovën nëse Kuvendi do të votojë serish kundër ngritjes së gjykatës, do të kishin qenë shumë serioze. Derisa alternativa e vetme do të mbetet që çështja të shkojë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. "Në botën e jashtme, kjo do të duket sikur Kosova po përpiqet të shmange thirrjen para përgjegjësisë të atyre që janë përgjegjës për krimet e luftës. Të paktën këtë mënyrë, Kosova mund të argumentojë se e ka njohur nevojën për të adresuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në vitin 1999".

Se çdo zgjidhje tjetër, jashtë votimit të Speciales do të çonte në një krizë serioze në mes të Kosovës dhe Perëndimit, e ka thënë edhe Bodo Weber, analist politik pranë Këshillit Politik të Demokratizimit.

"Sepse ajo që kemi vërejtur muajt e fundit ishte një përplasje në mes të Perëndimit dhe politikës së Kosovës se ciles ende i mungon qendrueshmëria, dhe një elite të brendshme që në masë të madhe nuk ka të trashëguara vlerat e sundimit të ligjit", ka thënë Weber.

vijon në faqen e tretë



Sarkofagu i Dresnikut, 1.700 vjet i vjetër, do të ekspozohet si artefakt i veçantë në Muzeun e Kosovës. Por një gjë e tillë do të bëhet tek pas konservimit. Kjo gjetje arkeologjike është konsideruar unike në Evropë dhe dëshmon nivelin e aristokracisë në vendin ku u zbulua. Njëzet portretet e Merkurit, që në mitologji njihet si përcjellësi i shpirtave në botën tjetër, zoti suprem dhe udhërrëfyes i të vdekurve, janë vetëm një pjesë e veçantive të kësaj vepre

ANALISTË NDERKOMBËTARE THONË SE GJYKATA SPECIALE NUK DO TË MUND T'I TRAJTOJË TË GJITHA KRIMET

Krimet jashtë raportit të Martyt, t'i gjykojë Kosova

James Ker-Lindsay, nga Instituti i Londrës për Shkenca Politike dhe Ekonomi (LSE), ka thënë se Kosova, pavarësisht themelimit të Gjykatës Speciale, duhet të dëshmojë përkushtim që t'i trajtojë krimet e tjera të cilat nuk janë të përfshira në raportin e Dick Martyt. Por avokati ndërkombëtar, Alexander Borg Olivier, e ka quajtur fatkeqësi për Kosovën themelimin e Speciales dhe se nuk pret ndonjë sukses nga kjo gjykatë

Vijon nga ballina

“Vendosmëria e Perëndimit për punën e prokurorëve të huaj ka dëmtuar vendimin e vitit të kaluar të BE-së për t’ia hequr EULEX-it mandatin ekzekutiv që ishte i bazuar në deklaratën e rrejtshme se drejtësia kosovare është e gatshme të gjykojë çështje të ndjeshme, si krimet e luftës, por edhe korrupsionin politik dhe krimin e organizuar”. Sipas Weberit, do të jetë interesante për të parë se çfarë do të bëjë BE-ja me mekanizmat e tjerë në Kosovë, kur Gjykata Speciale do të fillojë punën.

Por, i zhgënjyer dhe i shqetësuar me vendimin e Kuvendit për t’i hapur rrugë themelimit të Gjykatës Speciale është shprehur ish-shefi i Zyrtës Ligjore të UNMIK-ut, Alexander Borgia Olivier. Ai ka thënë se përfaqësuat e Kuvendit të Kosovës nu

nenstruan presionit ndërkombëtar për ta themeluar një mekanizëm jashtë sistemit gjyqësor të Kosovës.

“Kjo është alternativa më e gabuar. Gjykata do të mund të ishte themeluar në Kosovë me ndihmën ndërkombëtare, ashtu siç kërkohet për administrimin e duhur të drejtësisë në një vend normal shtetarr”, ka thënë Olivier.

“Me këto zhvillime Kosova ka dëshmuar se ende nuk është një demokraci e pjekur shtetare dhe e aftë për të mbijtur sovranitetin e fituar kohët e fundit dhe ta administrojë vetë drejtësinë. Me këtë zgjedhje Kosova mbetet, siç është konsideruar nga shumtë të tjerë, si një kuazishtet në hartesë, që nuk e ka nën kontroll faktin e vetë”.

Pasojat politike të Speciales

Kalimi i amendamentit dhe votimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrtën e Prokurorit të Specializuar, i ka hapur rrugë mijes së meqësorëve me shtetin e Holandës, për arrijtjen e marrëveshjes që një sell e Ketyre dhomave të vendoset në Hagë.

Bashkimi Evropian synon që gjithë hapat të cilët kërkohen prej tij t’i komplettojë deri në fillim të vitit 2016. Është parashikuar se menjëherë mund të ngjihen akuzat e

para të udhëhequra nga prokurori i Task Forces Speciale Hetuese të Bashkimit Evropian- SITF, David Schwendiman.

Duke folur për pasojat politike që mund të prodhojnë këto akuzatza James Ker-Lindsay ka thënë se shumë do të varret kush do të jenë të akuzuarit. Sipas tij, problemat qëndron në atë se shumë njerëz e kanë të veshitur la praninë se mund të jenë kryer krimet nga individë të caktuar brenda një kauze të përgjithshme që ka qenë e drejtë.

“Ka pasur zëra se të pandehurit do të përfshijnë figura të larta të qeverisë. Kjo mund qarte të çojë në tension dhe trazira politike. Megjithatë, ne do të duhet të presim dhe të shpohim. Edhe në qoftë se kjo nuk përfshin zyrtarë të lartë, aty me siguri do të jenë të shumtë, të cilët do të jenë të zëmëruar se njerëzit të cilët luftuan për Kosovën tanu janë duke u vendë para gjyqit. Kjo është e kuptueshme”, ka thënë ai. Lindsay ka thënë se shpreh shqetësimin e madh që ka për kur shpërbëhet e Kosovës.

“Në botën e jashtme, fakti që forcat serbe kishin kryer mitozorit e madha nuk mund të justifikohen me atë se ata që luftuan për Kosovën e që mund të kenë kryer vrasje, torturë, përdhunim ose krimet e tjera, të shkëlqet përtej standardeve të sjelljes duke mos i ndjekur. Kjo shpërbëje BE-ja dhe SHBA-ja kanë kërkuar me insistim këtë gjykatë”, ka thënë Lindsay.

Ky zëmtarin, sipas Lindsay, nuk është unik për Kosovën pasi kjo ka ndodhur kudo në ish-Jugosllavi.

“Vetëm konsiderojeni zëmtarin në Kroaci mbi akuzatza ndaj Gotovina, ose zëmtarin në mesin e bosnjakëve mbi EDK-tarin e Naser Oriçit. Për më tepër, me rëndësi është

te kibet parasysh fakti se akuzatza nuk do të thotë faj”.

Për sipas Weberit, është veshitë të parashikohen pasojat derisa nuk dihet lista e të akuzuarve.

“Nuk duhet të mbaje shpresa në pjesë e komunikimit diplomatik në Prishtinë se krijimi i Gjykatës do të ketë efekt antikor në demokratizimin e Kosovës përmas largmat të dasa figurave të rëndësishme të pasulites nga skera politike. Unë nuk jam aq i sigurt”, ka theksuar Weber. Sipas tij Kosova me shumë ka nevojë për disa ndryshime serioz socio-politike sesa të presë se do të vije diçka ndryshim prej besës se disa individëve të fuqishëm. Ndërsaq Alexander Borg Olivier që tanu punon si avokati ndërkombëtar në Kosovë nuk pret që Gjykata speciale të ketë ndonjë sukses.

“Gjykata Speciale e cila u bë e mundur vetëm me përligjimin e Kosovës, pas veprimat pozitiveres dhe të detyruar nga Kuvendi i Kosovës, do të kenë rrugë të ardhshme të ndryshme. Megjithatë, qysh në korrik të vitit 2014, drejtues të Task Forces Heterore Speciale (SITF) paten bërë të ditur se kanë gjetur prova bindëse për të ngjitur akuzatza ndaj drejtuesve të lartë të UÇK-së, pas një punë bebi-moore të bazuar në dëshmitë e ngjiturura. Sipas tyre, akuzatza do të ngjithen pas krijimit të mekanizmit gjyqësor, i cili do të mundësojë EDK-tin të parvarur të paarshtetm, transparent dhe të sigurt.

